

# Statistikat e Blegtorisë 2024

**Tiranë, më 23 Qershor 2025:** Në vitin 2024, blegtoria në Shqipëri ka shënuar disa ndryshime të rëndësishme në strukturë dhe prodhim, krahasuar me vitin paraardhës.

## Gjedhët

Numri i gjedhëve është rritur me 3,3%, nga 263 mijë krerë në vitin 2023 në 272 mijë krerë në vitin 2024. Megjithatë, numri i lopëve ka shënuar një rënie me 3,5%, duke zbritur nga 232 mijë në 224 mijë krerë.

## Të leshtat

Numri i përgjithshëm i të leshtave në vitin 2024 ka rënë me 2,5%, nga 1.206 mijë në 1.177 mijë krerë, krahasuar me 2023. Delet, si kategoria më përfaqësuese, kanë shënuar një rënie më të theksuar prej 3,8%, nga 1.006 mijë në 968 mijë krerë.

## Të dhirtat

Në vitin 2024, janë regjistruar 615 mijë krerë të dhirta, me një rënie prej 3,9%, krahasuar me një vit më parë (640 mijë). Brenda kësaj kategorie, numri i dhive është ulur me 2,2%, nga 512 mijë në 501 mijë krerë.

## Derra

Rënia më e madhe është regjistruar në kategorinë e derrave, me një ulje prej 9,4%, nga 115 mijë në 104 mijë krerë. Brenda kësaj kategorie, numri i dosave është reduktuar me 9,6%.

## Shpendët

Edhe pse numri total i shpendëve ka shënuar një rënie të lehtë prej 0,6%, nga 7.031 mijë në 6.992 mijë, numri i pulave ka pësuar një ulje më të theksuar prej 6,6%, duke zbritur nga 4.877 mijë në 4.557 mijë.

## Njëthundrakët

Numri i njëthundrakëve ka zbritur nga 67 mijë në 58 mijë krerë, që përfaqëson një rënie me 12,2%.

## Koshere bletësh

Numri i koshereve të bletëve është rritur me 13,2%, nga 519 mijë koshere në vitin 2023 në 587 mijë koshere në vitin 2024.

**Për publikim 23/06/2025**

## Prodhimet Blegtorale

### Qumështi

Prodhimi i përgjithshëm i qumështit është ulur me 2,7%, duke kaluar nga 900.569 tonë në vitin 2023 në 876.688 tonë në vitin 2024. Qumështi i lopës mbetet burimi kryesor, duke përbërë 84,9% të totalit, ndjekur nga qumështi i dhisë me 7,7% dhe ai i deles me 7,4%.

### Mishi

Prodhimi i mishit në peshë të gjallë ka pësuar një rënie prej 3,8%, nga 135.483 tonë në 130.334 tonë.

### Vezët

Edhe pse në vitin 2023 u prodhuan 894 milionë vezë, në vitin 2024 prodhimi ka rënë lehtë në 888 milionë, me një ndryshim prej -0,7%.

### Mjaltë

Prodhimi i mjaltit është rritur me 5,4%, nga 5.633 tonë në 5.940 tonë.

## Numri i krerëve të blegtorisë sipas qarqeve, 2024

Qarqet me numrin më të lartë për mbarështimin e gjedhit për vitin 2024, janë Fieri me 14,8% dhe Korça me 11,3%, ndaj numrit gjithsej të gjedhëve.

Përqëndrimi më i madh i numrit të të leshtave është në qarkun e Vlorës me 29,3% dhe në qarkun e Gjirokastrës me 14,5%, ndaj numrit gjithsej të krerëve.

Gjithashtu, në qarkun Vlorë dhe Gjirokastrë është përqëndrimi më i madh i numrit të të dhirtave me 25,6% me 14,0%, ndaj numrit gjithsej të krerëve.

Numri më i lartë i kategorisë së derrave është shënuar në qarkun Lezhë me 51,6% dhe në qarkun Shkodër me 24,2%, ndaj numrit gjithsej të krerëve.

Për më shumë informacion dhe për të parë tabelat e detajuara, vizitoni bazën e të dhënave në faqen zyrtare të INSTAT: [Statistikat e Blegtorisë](#)

# Metodologjia

Statistikat e blegtorisë për vitin 2024, mbështeten në informacionin administrativ, të mbledhur nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. Mbledhja, përpunimi dhe publikimi i statistikave blegtorisë dhe prodhimeve blegtorale mbështeten në:

- Ligj Nr. 17/2018 “Për Statistikat Zyrtare”;
- Ligj Nr. 30/2022 “Për miratimin e Programit të Statistikave Zyrtare 2022 – 2026”;

Duke zbatuar klasifikimet dhe përkufizimet sipas rregulloreve përkatëse të BE-së; Rregullorja Nr. 1165/2008 në lidhje me statistikën e blegtorisë dhe mishit; Rregullorja e Komisionit (EC) Nr. 1242/2008 mbi tipologjinë e njësive Bujqësore.

Informacioni mbledhet në terren nga specialistët e ekstensionit në të gjithë vendin. Këta specialistë mbledhin të dhëna drejtpërdrejt nga fermerët. Të dhënat blegtorale grumbullohen për numrin e kafshëve që mbarëshojnë fermerët si dhe prodhimet blegtorale. Specialistët e ekstensionit grumbullojnë të dhëna për ti krahasuar dhe me të dhënat e shërbimit veterinar i cili kryen matrikullimin dhe vaksinimin e kafshëve (proçesi është në vazhdimësi). Shërbimi veterinar kryen në momentin e vaksinimit inventarin e kafshëve në nivel komune. Specialistët e ekstensionit kanë marrëdhënie dhe me veterinerët privatë. Këta veterinerë kryejnë shërbime të ndryshme në mënyrë private pranë fermerëve (si kontroll nga sëmundjet, ngordhje të kafshëve apo lindje, therje, vaksinime etj). Në fund specialistët e ekstensionit krahasojnë të dhënat nga të tre burimet. Specialistët e ekstensionit grumbullojnë gjithashtu të dhëna për prodhimet bujqësore dhe blegtorale nga fermerët. Të dhëna për rendimentin e prodhimeve grumbullohen nga fermat më përfaqësuese në nivel komune. Të dhënat e grumbulluara dërgohen në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, ku specialistët e prodhimit blegtoral bëjnë vlerësime duke krahasuar të dhënat e grumbulluara nga terreni me të dhënat e fermave në vite.

Ministria e Bujqësisë përdor tre burime informacioni për grumbullimin e të dhënave:

1. Ekspertët e ekstensionit që janë pjesë e strukturave të Drejtorive të Bujqësisë
2. Shërbimin veterinar
3. Veterinerët privat

## Përkufizime

**Njësia Ekonomike Bujqësore (NJEB)** - është njësi e vetme, teknike ekonomike, e përcaktuar në një drejtim unik, nga terreni dhe pse në parcela jo të vazhdueshme, në të cilën realizohet prodhimi bujqësor dhe blegtoral që drejtohet nga një person i vetëm ose grup personash, për realizimin e veprimtarive bujqësore – blegtorale.

Njësi ekonomike bujqësore konsiderohen edhe njësitë ekonomike me drejtim të plotë blegtoral, në të cilat arrihet mbarështimi i kafshëve pa pasur në administrim tokë bujqësore, pra ku toka nuk figuron si element përbërës i njësisë.

**Njësia e gjedhit** - Njësia e gjedhit, e shkurtuar si LSU (Livestock Unit), është një njësi referimi që lehtëson agregimin dhe krahasimin e bagëtive nga specie dhe mosha të ndryshme, nëpërmjet përdorimit të koeficientëve specifikë të vendosur fillimisht në bazë të kërkesave ushqimore për çdo lloj kafshe. Njësia referencë e përdorur për llogaritjen e njësive blegtorale (=1 LSU) është ekuivalenti i një lope për qumësht që prodhon 3 000 kg qumësht në vit, sipas specifikimeve të dhëna në RREGULLORE (BE) 2018/1091 e Parlamentit dhe të Këshillit Evropian e datës 18 korrik 2018 mbi statistikën e integruara të fermave dhe shfuqizimin e Rregulloreve (KE) Nr 1165/2008 dhe (BE) Nr 1337/201.

**Blegtoria dhe shpendët** mbulojnë të gjitha kafshët pavarësisht nga mosha e tyre vendndodhja ose qëllimi i tyre për mbarështim. Kafshët mund të jenë prezent në Njësinë Ekonomike Bujqësore, ose jashtë fermave bujqësore në kullotë.

#### **Klasifikimi**

Klasifikimi i kafshëve bëhet sipas llojeve (gjedhë, të leshta, të dhirta, derra, kuaj), sipas moshës, seksit dhe destinacionit ekonomik.

Shpendët janë të grupuar në një grup të vetëm dhe përfshihen pulat, pulat afrikane, gjela deti, pata, rosa, etj.

#### **Prodhim mishi peshë e gjallë**

Vlerësimi për prodhimin e mishit peshë e gjallë kryhet për çdo lloj kafshe. Llogaritja e prodhimit të mishit peshë e gjallë bazohet në përlogaritjet e bëra nga lëvizja e blegtorisë, pra në numrin e krerëve të skartuar për gjedhë, të leshta, të dhirta, derra dhe shpendë, sipas kategorive të therjes, dhe në peshën e gjallë mesatare për krerë të therur sipas llojeve dhe kategorive të therjes.

#### **Rregullat kryesore për grumbullimin e të dhënave**

Numri i krerëve të blegtorisë i referohet datës 1 Dhjetor 2024.

Fermeri pyetet për të gjitha llojet e kafshëve që ai zotëron.

Informacioni grumbullohet vetëm për numrin e krerëve që ka në zotërim njësi ekonomike bujqësore

Të gjitha kafshët e blera nga ekonomi të tjera gjatë vitit numërohen.

Të gjitha kafshët e shitura ekonomike të tjera gjatë vitit nuk numërohen.

Lindjet e blegtorisë janë të lindurit gjatë 12 muajve të fundit. Nuk përfshihet blegtoria lindur e ngordhur.

Humbjet e kafshëve gjatë vitit, ngordhje, ngrënie nga egërsirat, apo nga shkaqe natyrore nuk numërohen.